



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

CN.nr.212/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Rustem Thaqi dhe Milena Gjeriq, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Blerim Mazreku, avokat nga Prizreni, kundër të paditurit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Shëndetësisë, me seli në rr. "...", P., duke vendosur lidhur me kompetencën lëndore, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24.04.2024, merr këtë:

### A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike të kreditorit Komuna e Prizrenit, ë paditësit Komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Blerim Mazreku, avokat nga Prizreni, kundër të paditurit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Shëndetësisë, me seli në rr. "...", P., kompetente lëndore është Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

### A r s y e t i m i

Paditësi Komuna e Prizrenit, me datë 23.08.2022 përmes të autorizuarit të tyre ka parashtruar padi për kompensimin e dëmit material nga zbatimi i Kontratës Kolektive Sektoriale, kundër të paditurit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Shëndetësisë, në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm. Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin C.nr.4172/22, të datës 22.12.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje dhe lëndën e ka dërguar për vendosje në Gjykatën Komerciale të Kosovës – Departamenti për Çështje Ekonomike, me arsyetim së në kuptim të dispozitave nga neni 13 par.1 të Ligjit 06/L-është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për trajtimin e çështjes, duke u bazuar në nenin 13 paragrafi 1, nën paragrafi 1 të Ligjit 08/L-015 për

Gjykatën Komerciale. Pas shqyrtimit paraprak të prapësimit, gjykata nga shkresat e lëndës vëren se as kreditori e as debitori nuk janë shoqëri tregtare, rrjedhimisht gjykata në bazë të nenit 19 lidhur me nenin 392 të LPK-së kryesisht e shqyrtoi kompetencën e vet lëndore

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e vet, 178/2024, të datës 178.04.2024, ka hapur konfliktin e kompetencës, në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke konsideruar se nuk kemi të bëjmë me kompetencë të Gjykatës Komerciale sepse pas shqyrtimit paraprak të prapësimit, gjykata nga shkresat e lëndës vëren se as kreditori e as debitori nuk janë shoqëri tregtare, rrjedhimisht gjykata në bazë të nenit 19 lidhur me nenin 392 të LPK-së kryesisht e shqyrtoi kompetencën e vet lëndore. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme, të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në nenin 25.2 të LPK-s dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr. 08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.

Me vështrim në nenin 13 pika 1.1. të Ligjit Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, parashihet se përveç tjerash "Gjykata Komerciale ka juridiksion ekskluziv vetëm në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre; kontestet në lidhje me pengimin e posedimit në mes të shoqërive tregtare dhe kontestet në mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore dhe për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të legjislacionit të aplikueshëm për këtë çështje, gjeti se duke u bazuar në faktin se palë në procedurë janë Komuna e Prizrenit dhe Ministria Shëndetësisë dhe objekt i kontestit është kompensimi i dëmit, nga ky aspekt erdhi në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me pagesën e shpronësimit të pronave dhe sipas Gjykatës Supreme të Kosovës, në këtë rast edhe pse kemi të bëjmë me persona juridik, nuk kemi të bëjmë me çështje të ndërsjella tregtare, e që sipas dispozitave ligjore të lartcekura, është kusht që palët të jenë persona juridik dhe njëkohësisht kontesti të ketë të bëjë me çështje të ndërsjella tregtare, pra të plotësohen këto dy kushte në mënyrë komulative, nëse njëra nga këto mungon atëherë nuk kemi të bëjmë me çështje

tregtare dhe rrjedhimisht nuk është në kompetencë të Gjykatës Komerciale -Dhomat e Shkallës së parë dhe të Dytë, për të gjykuar në këtë çështje juridike.

Andaj Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatë kompetente lëndore për të vendosur sipas padisë se paditësve është Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, në pajtim me nenin 12.1 të Ligjit Nr. 06/L - 054 për gjykatat, i cili parasheh se "Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe". Prandaj për të vendosur për këtë çështje lënda i dorëzohet Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË**

CN.nr.212/2024 datë 24.04.2024

Kryetari i kolegjit,  
Beshir Islami